



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI**

**PROCESVERBAL<sup>1</sup>**

**(I përmbledhur)**

Tiranë, më 05.04.2019, ora 10.00

**Drejton mbledhjen -**

**Ardian Dvorani – Kryetar i Këshillit**

**Rendi i Ditës :**

*1. Informacion për vendet vakante për të cilat organet e emërtesës kanë vënë në lëvizje Këshillin, si edhe kandidatët e paraqitur për secilin vend vakant.*

*2. Diskutimi dhe miratimi i fillimit të procedurave për verifikimin, vlerësimin, pikëzimin dhe renditjen e kandidaturave në vendet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe për Inspektor i Lartë i Drejtësisë, si edhe të njoftimit zyrtar publik për fillimin e këtij procesi.*

*3. Diskutimi dhe miratimi i projektvendimit për njoftimin e Gjykatës së Lartë, si subjekt që e ka vënë në lëvizje Këshillin, për të vlerësuar rishpalljen e thirrjes për paraqitjen e kandidaturave për dy pozicione vakante në Gjykatën Kushtetuese;*

*4. Informacion për disa masa të organizimit të punës me personelin administrativ mbështetës në funksion të kryerjes së procedurave të verifikimit dhe përzgjedhjes së kandidaturave.*

*5. Diskutim dhe miratimi i kryerjes së procedurave të shortit për caktimin e relatorëve përkatës të vendeve vakante, llojin e shortit dhe mënyrën e zhvillimit të tij;*

*6. Diskutimi dhe miratimi i Njoftimit Publik për të kërkuar informacione lidhur me kandidaturat.*

<sup>1</sup>Për shkak të parashikimit shprehimisht në ligjin nr.115/2016 (neni 226 pika 1 shkronja "d", neni232 pika 2, neni 242 shkronja "c") dhe Rregullores së Brendshme të Funkcionimit të KED-së (neni 17), referuar pengesës ligjore për të bërë publike diskutimet e vetë anëtarëve të KED krahas qëndrimeve të tyre për çështjen e rendit të ditës, natyra përmbledhëse e procesverbalit, imponon që edhe diskutimet e Avokatit të Popullit dhe subjekteve të ftuara të pasqyrohen në mënyrë të përmbledhur. KED, disponon materialin e plotë audio dhe te zbardhur me shkrim të çdo mbledhje, sipas ligjit.

**Marrin pjesë :**

- |                          |                        |
|--------------------------|------------------------|
| 1. Ardian Dvorani        | (kryetar)              |
| 2. Vitore Tusha          | (zëvendës kryetare)    |
| 3. Arta Marku            | (anëtare)              |
| 4. Fatri Islamaj         | (anëtar)               |
| 5. Fatjona Memçaj        | (anëtare)              |
| 6. Eriol Roshi           | (anëtar)               |
| 7. Gurali Brahimllari    | (anëtar zëvendësues)   |
| 8. Klodiana Veizi (Mema) | (anëtare zëvendësuese) |

**Merr pjesë, si vëzhguese e përhershme :**

1. Erinda Ballanca, Avokati i Popullit

**Marrin pjesë, si të ftuar, përfaqësues nga subjektet e treguar në nenin 233/2 të ligjit nr. 115/2016:**

1. Bledar Dervishaj, përfaqësues i Presidentit të Republikës
2. Mimoza Arbri, përfaqësuese e Kryetarit të Kuvendit

**HAPET MBLEDHJA**

*Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani, deklaron të hapur mbledhjen.*

Verifikohet prania dhe pjesëmarrja e anëtarëve të Këshillit.

Informohet Këshilli se nuk merr pjesë në mbledhje për shkak të një angazhimi zyrtar jashtë vendit anëtarja e Këshillit Margarita Buhali, e cila, sipas ligjit, për mbledhjen e sotme zëvendësohet nga anëtari zëvendësues Gurali Brahimllari.

*Ardian Dvorani* lexon çështjet e rendit të ditës të njoftuar paraprakisht:

*1. Informacion për vendet vakante për të cilat organet e emërtesës kanë vënë në lëvizje Këshillin, si edhe kandidatët e paraqitur për secilin vend vakant.*

*2. Diskutimi dhe miratimi i fillimit të procedurave për verifikimin, vlerësimin, pikëzimin dhe renditjen e kandidaturave në vendet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe për Inspektor i Lartë i Drejtësisë, si edhe të njoftimit zyrtar publik për fillimin e këtij procesi.*

3. *Diskutimi dhe miratimi i projektvendimit për njoftimin e Gjykatës së Lartë, si subjekt që e ka vënë në lëvizje Këshillin, për të vlerësuar rishpalljen e thirrjes për paraqitjen e kandidaturave për dy pozicione vakante në Gjykatën Kushtetuese;*

4. *Informacion për disa masa të organizimit të punës me personelin administrativ mbështetës në funksion të kryerjes së procedurave të verifikimit dhe përzgjedhjes së kandidaturave.*

5. *Diskutim dhe miratimi i kryerjes së procedurave të shortit për caktimin e relatorëve përkatës të vendeve vakante, llojin e shortit dhe mënyrën e zhvillimit të tij;*

6. *Diskutimi dhe miratimi i Njoftimit Publik për të kërkuar informacione lidhur me kandidaturat.*

Shtrohet për diskutim miratimi i rendit të ditës së paraqitur për këtë mbledhje të Këshillit.

**Anëtarët e Këshillit** miratojnë rendin e ditës së programuar.

**Këshilli vijon mbledhjen** me sipas rendit të ditës. Ardian Dvorani parashtroi informacionin lidhur me vendet vakante që janë krijuar në Gjykatën Kushtetuese për secilin organ emërtesë, llojin e vakancave, kohën e krijimit të tyre, kohën e paraqitjes së kandidaturave në KED, numrin e kandidatëve dhe të kandidaturave, sikurse edhe kohën e shpalljes dhe numrin e kandidatëve për vakancën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Në kushtet kur KED paraardhës nuk kanë funksionuar nuk ka qenë e mundur të respektohen afatet ligjore për fillimin e procedurës së verifikimit, vlerësimit dhe renditjes brenda 5 ditëve nga paraqitja e listës së kandidatëve pranë KED. Sipas rregullave normative kalimtare të miratuara nga KED për këto rrethana, procedurat e verifikimit dhe renditjes së kandidatëve për të gjitha këto vakanca duhet të fillojnë njëherazi me miratimin e mbledhjes së sotme.

**Bledar Dervishaj** kërkon fjalën dhe lidhur me Tabelat informuese të përgatitura për pjesëmarrësit parashtroi se në këto tabela nuk duhet të vendoset kohëzgjatja, pra koha e mbarimit të mandateve sepse KED nuk e ka këtë kompetencë. Kjo do të jetë një çështje që vetë Gjykata Kushtetuese do ta vlerësojë në momentin kur të jetë funksionale.

**Anëtarët e Këshillit** diskutojnë dhe vendosin të riformulojnë Tabelat informuese për përdorim të brendshëm të vakancave dhe kandidaturave duke iu referuar kohës së shpalljes së vakancës nga organet e emërtesës.

**Anëtarët e Këshillit** diskutojnë dhe vendosin unanimisht fillimin e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidaturave për të gjitha vendet vakante që janë shpallur nga organet e emërtesës, për të cilat janë depozituar në dokumentacionet përkatëse pranë KED.

*Anëtarët e Këshillit* diskutojnë për mundësinë e vendimmarrjes së menjëhershme, pa kaluar në procedurën e shortit dhe veprimet e tjera thjesht formale, kjo me qëllimin e njoftimit, pa zvarritje të proceseve, të organit të emërtesës, Gjykatës së Lartë, për të konsideruar rishpalljen e konkurrimit për vendet vakante për shkak të mungesës së kandidaturave apo të më pak se tre kandidaturave për secilën vakancë.

*Bledar Dervishaj* kërkon fjalën dhe parashtron se është detyrë e Këshillit të mirëadministrojë proceset që lidhen me vakancat. Këshilli është organ emërtese për ILD, ndaj para dy javësh konstatoi vetë që nuk kishte një numër të mjaftueshëm kandidatësh për të çuar në Kuvend dhe bëri rishpalljen. Kjo duhet të ishte ndjekur edhe nga Gjykata e Lartë, si organ emërtese dhe nesër nga Presidenti. Nëse do të kishim mungesë kandidatësh do e rishpallnim vakancën. Këtë bën edhe KLP. Por meqënëse nuk është kryer deri tani, pasoja që vjen nga ky vendim i menjëhershëm i Këshillit është më tepër nxitje e procesit që të kemi pak shpejtësi. Nëse e bën më vonë është po prapë Këshilli që do ta konstatojë këtë, me ndryshimin që do tia ia thotë një relator anëtar i Këshillit. Ndërkohë që është evidente. Këshilli po konstaton se nuk ka çfarë bën me këto tre vakanca të Gjykatës së Lartë. Në këtë kuptim, për kursimin e kohës, mendoj që Këshilli duhet ta marrë përsipër këtë.

*Anëtarët e Këshillit* diskutojnë dhe vendosin unanimisht pezullimin e procedurave të verifikimit të kandidaturave dhe njoftimin e subjektit që e ka vënë në lëvizje, Gjykatën e Lartë, për të vlerësuar rishpalljen e thirrjes për paraqitjen e kandidaturave për të tre vendet vakante në Gjykatën Kushtetuese.

*Ardian Dvorani*, sipas rendit të ditës vijon me paraqitjen e informacionit lidhur me disa masa të organizimit të punës me personelin administrativ mbështetës në funksion të kryerjes së procedurave të verifikimit dhe përzgjedhjes së kandidaturave, numrin dhe llojin e personelit mbështetës që me kohë të pjesshme janë vënë në dispozicion të KED nga ana e Gjykatës së Lartë, krijimin në faqen zyrtare të kësaj Gjykate të pjesës së posqme për KED, krijimin e domain ked.gov.al dhe të 5 adresave elektronike të KED për komunikim me kandidatët, institucionet dhe subjektet në kuadër të procedurave të verifikimit dhe vlerësimit të kandidaturave, si edhe të adresave elektronike zyrtare për secilin anëtar të KED. Gjithashtu informohet Këshilli për përgatitjen e dokumenteve standarde që do të përdoren për kërkimin e informacioneve nga institucionet dhe subjektet e tjerë në kuadër të procedurave të verifikimit dhe vlerësimit të kandidaturave, si edhe me kandidatët, për organizimin paraprak të punës në komunikimin dhe bashkërendimin e veprimeve të KED, relatorëve dhe këshilltarëve në dispozicion të KED etj..

*Anëtarët e Këshillit* diskutojnë për mundësinë dhe nevojën e kërkimit nga Gjykata e Lartë të një numri më të madh të personelit mbështetës për veprimtarinë e KED duke qenë se janë shumë vende vakante njëkohësisht në proces.

Pasi informohen nga *Ardian Dvorani* lidhur me gatishmërinë e Gjykatës së Lartë për të vënë në dispozicion të KED të pajisjeve, ambienteve dhe burimeve të mundshme njerëzore, si edhe për gjendjen dhe ngarkesën po ashtu të jashtëzakonshme ku gjendet Gjykata e Lartë ku mungojnë jo vetëm gjyqtarë por edhe numri i këshilltarëve dhe sekretarisë është dukshëm i reduktuar në numër, pra edhe për pamundësinë e caktimit të këshilltarëve me kohë të plotë pranë KED, anëtarët e Këshillit dhe subjektet e tjerë pjesëmarrës në mbledhje vlerësuan ti drejtohen edhe njëherë Kryetarit të Gjykatës së Lartë për të shikuar mundësinë e rritjes së mbështetjes me personel të veprimtarisë së KED.

*Anëtarët e Këshillit*, sipas rendit të ditës, vijojnë të diskutojnë për mënyrën e procedimit me shortin për caktimin e relatorëve për vendet vakante.

*Anëtarët e Këshillit*, pasi shqyrtuan edhe raportin teknik të sektorit IT të Gjykatës së Lartë që argumenton pamundësinë teknike të realizimit të shortit në mënyrë elektronike, vendosën që sipas ligjit të procedohet me realizimin e shortit në mënyrë manuale për caktimin e relatorëve për vendet vakante, si edhe për mënyrën dhe radhën që do të ndiqet për zhvillimin e këtij shorti.

Së fundi, *anëtarët e Këshillit* diskutuan nevojën dhe miratuan përmbajtjen e njoftimit publik për të kërkuar informacione lidhur me kandidaturat në procedurat e verifikimit, vlerësimit dhe të renditjes së tyre në vendet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë.

Në përfundim të këtyre diskutimeve mbi çështjet e rendit të ditës, anëtarët e Këshillit vendosën të mbyllet mbledhja lidhur me këtë rend dite dhe më pas të vijohet me zhvillimin e procedurave të shortit manual për caktimin e relatorëve për vendet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë.

## **MBYLLET PJESA E PARË E MBLEDHJES**

**NË PJESËN E DYTË TË MBLEDHJES, duke filluar nga ora 12.03, realizohen veprimet e shortit për caktimin e anëtarëve të Këshillit relatorë për vendet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe për Inspektor i Lartë i Drejtësisë.**

***Procesverbali i hedhjes së shortit i bashkëlidhet këtij procesverbal të mbledhjes së Këshillit.***

## PJESA E TRETË E MBLEDHJES

*Ardian Dvorani*, informon anëtarët e Këshillit dhe pjesëmarrësit e tjerë se ky është rezultati i shortit, i cili do të bëhet publik jo vetëm si detyrim ligjor por edhe për efekt të transparencës. Gjithashtu, informohen anëtarët për masat organizative të marra për ndarjen e punës mes këshilltarëve në proceset e njoftimit të të gjithë kandidatëve për të gjitha vendet vakante për tu paraqitur në kryerjen e procedurave, mjetet e komunikimit, dokumentet standarde ose formularët standarde dhe autorizimet, të shoqëruara edhe me udhëzime e orientime për kandidates.

*Bledar Dervishaj* kërkon fjalën dhe parashtron se njoftimi publik, do të kërkoja që tu shkonte në vesh organeve të rivlerësimit kalimtar, e kemi diskutuar sa e sa herë në Këshill. Nevojitet tu bëhet një kujtese atyre. Ne si Presidencë do e bëjmë por edhe nga Këshilli duhet.

Lidhur me anën e transparencës Avokatja e Popullit ka bërë një kërkesë me shkrim per sa i takon atyre parashtrimeve që dikton ligji dhe rregullat e organizimit dhe funksionit të Këshillit. Do të duhet që procesverbalet, me ekstraktet të paktën, ne si të ftuar të njihemi, të japim komentet tona, të miratohen dhe të publikohen sepse ka mbetur vetëm procesverbali i datës 15 janar. Tashmë që filloi ky proces i gjithë publiku të njihet. Është për tu pasur në vëmendje sepse e dikton edhe rregullorja.

*Anëtarët e Këshillit* diskutojnë për mënyrën e procedimit me përgatitjen e diskutimit lidhur me Metodologjinë për vlerësimin dhe pikëzimin e kandidatëve për Gjykatën Kushtetuese dhe atij për kandidatët për Inspektor i Lartë i Drejtësisë, përcaktimin e atyre që do të angazhohen dhe për bashkëpunimin e mundshëm me EURALIUS.

*Bledar Dervishaj* kërkon fjalën dhe parashtron se ky Këshill ka ndjekur një logjikë ku propozimet fillestare ose draftet fillestare të akteve nënligjorë janë hartuar nga EURALIUS dhe EURALIUS e ka për detyrë sipas kontratës së bashkëpunimit që ka me shtetin shqiptar. Të asistojë edhe KED, Kuvendin dhe të gjitha institucionet që janë parashikuar në reformën në sistemin e drejtësisë. Kështu që një kërkesë tjetër tek EURALIUS nuk është e shtuar, por është një detyrë e tyre. Ne si institucione të ftuara, si organe emërtese, edhe Avokati i Populli kemi dhënë komente dhe do vazhdojmë të japim komente edhe për hartimin e kësaj metodologjie.

Në këto mbledhje kane dalë dhe problematika të vetë ligjit, paqartësi, diku kundërshti, që Kuvendi meqenëse ka qenë prezent duhet ti vlerësojë. Kështu që Kuvendi do të duhet të vlerësojë te gjitha problematikat që janë shfaqur gjatë implementimit në lidhje me ligjet në fjalë.

*Mimoza Arbi* kërkon fjalën dhe parashtron se të gjitha problematikat që kanë dalë këtu ne e kemi detyrë që ti paraqesim një informacion Kryetarit të Kuvendit. Por për sa i përket

ndryshimeve, qoftë në ligjin nr.115 për shkak të vendimit të Gjykatës Kushtetuese dhe në ligjin nr.96 për statusin e gjyqtareve, këto ndryshime duhet të bëhen duke u mbledhur Këshilli i Legjislacionit, i cili, për shkak të largimit të deputeteve të opozitës, nuk mund të mblidhet. Në ne Rregulloren e Kuvendit parashikohet që përbehet nga 10 anëtare, me anëtarësi të barabartë. Me krijimin e opozitës së re dhe të këshillit të ri, do të fillojë të funksionojë dhe pak a shumë është përgatitur dhe drafti e ndryshimit të ligji nr.115 dhe nr. 96.

*Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani*, deklaroi mbylljen e mbledhjes.

### **MBLEDHJA MBYLLET NË ORËN 13.05**

**SEKRETARE**

**KRYETARI**

**Redjona MYRTJA**

**Ardian DVORANI**

**Dorina DULAJ**